



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

BE QENDRA E KUVENDIT

BE LAJME

nëntor 2017

EUC– numer 28/2017



FORUMI NDËRKOMBËTAR PËR AJËR TË PASTËR



Më 16 dhe 17 nëntor të këtij viti në Paris, u mbajt forumi i parë i për ajër të pastër me mbi 300 pjesëmarrës nga industria, përfaqësues të qeverisë, organizata joqeveritare dhe qytetarët të cilët ndanë qëndrimet për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Më shumë se 30 folës u ndalën në n sfidën për ajër të pastër, aktorët dhe fushat e veprimit. Në fokus të diskutimit ishin tre tema: Kualiteti i ajrit në qytete; ndotja e ajrit në sektorin bujqësor; dhe mundësitë e biznesit për ajër të pastër.

Folësit kryesor ishin: Karmen Vela komisarë për mjedisi jetësor, çështje detare dhe peshkim; Pjer Moskoviçi kryetare e komunës së e Parisit; Shirli Rodriguez zëvendëskryetare e Londrës; dhe Hans Briniks, drejtor ekzekutiv i Agjencisë Evropiane për Mjedis Jetësor.

Debati vërtetoi se BE nuk ka pako gjithëpërfshirëse me mjetet për ndihmë në zgjidhjen e sfidës për ajër të pastër: zgjidhje ligjore për standardet për kualitet të ajri dhe plafon nacional të ndotjes së ajrit. Ai gjithashtu përfshin standardet specifike të ndotjes për burimet kryesore të ndotjes, si dhe teknikat më të mira në dispozicion për të penguar emetimet industriale. Forcimi i unionit energjetik, lëvizje drejt mobilitetit me emisione të ulëta dhe zhvillimi i mëtejshëm i Politikës së Përbashkët Bujqësore, mund të ndihmojnë më shumë në reduktimin e ndotjes së ajrit. Detyra është që të implementohen politikat të cilat do të "punojnë" për ajër të pastër.

mbi 300 pjesëmarrës nga industria, përfaqësues të qeverisë, organizata joqeveritare dhe qytetarët të cilët ndanë qëndrimet për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Më shumë se 30 folës u ndalën në n sfidën për ajër të pastër, aktorët dhe fushat e veprimit. Në fokus të diskutimit ishin tre tema: Kualiteti i ajrit në qytete; ndotja e ajrit në sektorin bujqësor; dhe mundësitë e biznesit për ajër të pastër.

Folësit kryesor ishin: Karmen Vela komisarë për mjedisi jetësor, çështje detare dhe peshkim; Pjer Moskoviçi kryetare e komunës së e Parisit; Shirli Rodriguez zëvendëskryetare e Londrës; dhe Hans Briniks, drejtor ekzekutiv i Agjencisë Evropiane për Mjedis Jetësor.

Debati vërtetoi se BE nuk ka pako gjithëpërfshirëse me mjetet për ndihmë në zgjidhjen e sfidës për ajër të pastër: zgjidhje ligjore për standardet për kualitet të ajri dhe plafon nacional të ndotjes së ajrit. Ai gjithashtu përfshin standardet specifike të ndotjes për burimet kryesore të ndotjes, si dhe teknikat më të mira në dispozicion për të penguar emetimet industriale. Forcimi i unionit energjetik, lëvizje drejt mobilitetit me emisione të ulëta dhe zhvillimi i mëtejshëm i Politikës së Përbashkët Bujqësore, mund të ndihmojnë më shumë në reduktimin e ndotjes së ajrit. Detyra është që të implementohen politikat të cilat do të "punojnë" për ajër të pastër.

<http://europa.eu>
<https://www.euconf.eu>

Përmbajtja e lajmeve:

Forumi ndërkombëtar për ajër të pastër	1
Aktivitetet e Kuvendit lidhur me Çështjet Evropiane	2-3
Në fokus të Parlamentit Evropian	4-5
Përkrahje e medieve në Ballkanin Perëndimor	6
Paris - qyteti më inovativ për vitin 2017	7
Bashkëpunimi më i fuqishëm i BE në sferën e mbrojtjes	8
Seli të reja të dy Agjencive Evropiane	9
Përdorimi i glifosat i vazhduar edhe për pesë vite	10
Çmim special për komunikim për projektin studentor "Pse Evropa"	11
BE kalendari/ dhjetor 2017	11

Më 16 dhe 17 nëntor të këtij viti në Paris, u mbajt forumi i parë i për ajër të pastër me

AKTIVITETET E KUVENDIT LIDHUR ME ÇËSHTJET EVROPIANE



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë z. Talat Xhaferi më 20 nëntor 2017 u takua 2017 Eurokomisionerin për Politikat e Fqinjësisë dhe Negociatat për Zgjerimit të Bashkimit Evropian, z. Johanesh Han.

Presidenti e njoftoi Eurokomisionerin për aktivitetet vijuese dhe ato në vijim të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë lidhur me proceset e reformës të nevojshme për marrjen e rekomandimit pozitiv për fillimin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Eurokomisioneri Han realizoi takime individuale me kryetarin e koalicionit "Aleanca për Shqiptarët", kryetarin e BDI-së dhe kryetarin e VMRO-DPMNE-së



Më 09 dhe 10.11.2017 në vizitë në Kuvend qëndroi eurodeputeti Ivo Vajgl, i cili realizoi takim me kryetarin e Kuvendit dhe takime individuale me koordinatorët e BESA, VMRO-DPMNE, PDSH, LSDM, BDI dhe Aleanca për Shqiptarët, me kryetarët e dy komisioneve parlamentare të mbikëqyrjes, dhe ekspertët e BE për Projektin Parlamentar.

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë z. Talat Xhaferi më 10 nëntor 2017 realizoi takim me sekretarin shtetëror për Çështjet e Jashtme dhe Evropiane të Republikës Sllovaqe z. Ivan Korçok Në takim, bashkëbiseduesit shkëmbyen pikëpamje për integrimet euroatlantike të Republikës së Maqedonisë. Kryetari i Kuvendit e informoi mysafirin për qasjen e ndryshme pozitive për këtë çështje, veçanërisht duke përmirësuar marrëdhëniet me fqinjët dhe duke filluar reformat që janë të nevojshme për integrimin euroatlantik të Republikës së Maqedonisë.



Më 15 nëntor 2017 u mbajt Konferenca Rajonale e Rrjetit të Komisioneve Parlamentare për Ekonomi, Financa dhe Eurointegritime të Ballkanit Perëndimor. Kryetari i Kuvendit, z. Talat Xhaferi në fjalimin e tij theksoi se një nga funksionet themelore të çdo parlamenti, krahas legjislativ, është edhe funksioni mbikëqyrës.

"Sot, ky rrjet përfshin 25 komisione nga Parlamentet e Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë, Malit të Zi, Kosovës dhe Serbisë dhe unë personalisht mendoj se paraqet mjet të rëndësishëm në proceset e integritimit evropian të vendeve të rajonit", tha z. Xhaferi.

AKTIVITETET E KUVENDIT LIDHUR ME ÇËSHTJET EVROPIANE



Delegacioni nga Kuvendi i kryesuar nga kryetari i Kuvendit më 27 dhe 28 nëntor 2017 realizoi vizitë zyrtare në Mbretërinë e Suedisë. Kryetari i Kuvendit zhvilloi takime individuale me kryetarin e Parlamentit Suedez Urban Alin, me kryebashkiakun e Stokholmit Eva-Luiz Erlandson Slorah, me ministri e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Suedisë Margot Vallstrom. Për kryetarin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë u realizua Audiencia tek Mbreti i Suedisë, shkëlqesia e tij Karl XVI Gustav.

kaj Кралот на Шведска, Неговото Височество Карл XVI Густаф

Kryetari i Komisionit për Çështjet Evropiane Artan Grubi më 7 nëntor 2017 mori pjesë në punëtorinë për krijimin e një rrjeti rajonal të komisioneve për Çështje Evropiane. Në seminar morën pjesë përfaqësues të Komisioneve për Çështje Evropiane nga Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Bosnja, Kosova dhe Shqipëria.

Qëllimi i punëtorisë ishte krijimi i rrjetit rajonal të Komisioneve për Çështje Evropiane, me qëllim të vazhimit të bashkëpunimit të mëtejshëm.



Në konferencën kushtuar zhvendosjes së hendekut midis politikave rinore, pjesëmarrjes së të rinjve dhe deputetëve, organizuar nga Parlamenti Evropian më 21 nëntor 2017 në Bruksel, mori pjesë delegacioni i Kuvendit i përbërë nga: Ivana Tufegxhiq, Dimitar Stevanxhija, Agim Shaqiri dhe Teuta Billali. Deputetja Tufegxhiq në fjalimet e saja informoi r rreth nivelit të realizimit të reformave të dedikuara drejt politikave për të rinj në Republikën e Maqedonisë. Edhe deputetët tjerë morën pjesë aktive në Konferencë. Ata patën takime të shumta me kolegë nga rajoni dhe Parlamenti Evropian, të cilët ishin në drejtim të promovimit të Republikës së Maqedonisë dhe shkëmbimit të përvojave dhe mendimeve.



Klubi për Çështje Rinore dhe Politike më 13.11.2017, realizoi takim me shefin e Sektorit për të Rinj në Këshillin e Evropës, z-nja Antie Rotemund. Qëllimi i takimit ishte të dëgjonin përvojat, praktikat dhe politikat që do t'i ndihmojnë Klubit për Çështje Rinore dhe Politike të bëhen urë përmes së cilës të rinjtë mund të shprehin idetë e tyre dhe t'i interpretojnë ato në organin ligjvënës.

Delegacioni i deputetëve të Kuvendit në përbërje të Artan Grubit, Nikolla Poposki dhe Fadil Zendeli, më 20 dhe 21 nëntor 2017 morën pjesë në Konferencën e Parlamentin Evropian në Bruksel kushtuar integritetit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian deputeti Grubi informoi për rrjedhën e procesit reformues në Maqedoni, për përkushtimin e shumicës së re të që t'i konsolidojë detyrat e përcaktuara nga Brukseli me qëllim deri në fund të vitit për të marrim rekomandim të pakushtëzuar për fillimin e negociatave dhe madje edhe datë konkrete për fillimin të të njëjtave.

Deputeti Poposki u bëri thirrje përfaqësuesve të Unionit për praninë dhe vizibilitet më të madhe në Republikën e Maqedonisë, si dhe për bashkëpunim më të madh të të gjitha vendeve nga rajoni në lidhje me agjendën evropiane. "Suksesi i integritetit varet nga mundësia e kontrollit më të madh të Qeverisë nga ana e Kuvendit," tha Popovski. Deputeti Zendeli iu drejtua sesionit të dedikuar për përdorimin e instrumentit IPA-2.



NË FOKUS TË PARLAMENTIT EVROPIAN



<http://www.europarl.europa.eu>

Sesioni plenar 13-16 nëntor 2017

Deputetët kritikuan në debatin urgjent për rrjedhjet e fundit të medieve të parajsave ofshor të tatimeve njohur si "dokumente parajse". Eurodeputetët theksuan se ministrat e Financave nuk duhet të fshihen pas rregullave të unanimitetit në luftën kundër evazionit fiskal. Aktualisht, vendimet për tatimet që grumbullohen në nivel të BE duhet të dakordohen nga të gjitha shtetet anëtare. Duke iu përgjigjur pyetjeve të eurodeputetit, Pjer Moskoviçi, Komisionari për Çështjet Ekonomike dhe Financiare, Tatimet dhe Doganat, paralajmëroi se BE duhet të bëjë përpunim në trajtimin e këtij "problemi fundamental" në çështjet e tatimeve.

Sipas rregullativës së rishikuar të mbrojtjes së konsumatorit, organet nacionale të zbatimit do të kenë më shumë kompetenca për të zbuluar dhe luftuar shkeljet onlajn të ligjeve të mbrojtjes së konsumatorit. Teksti ligjor u miratua nga Parlamenti Evropian me 591 vota dhe duhet të miratohet zyrtarisht nga Këshilli i BE-së. Regullativa do të zbatohet 24 muaj pas ditës së hyrjes në fuqi.

Kryetari i Parlamentit Evropian Antonio Tajani uroi tre finalistët e çmimit Luks, duke përfshirë edhe ekuipazhin e filmit fitues, dhe theksoi: "Çmimi Luks është në ballë të promovimit të filmit, që është bërë në Evropë, në industrinë tonë kreative dhe në diversitetin tonë kulturor dhe gjuhësor".

Parlamenti Evropian e miratoi marrëveshjen joformale për rregullat e reja të BE për luftë kundër dumpingut dhe importeve të subvencionuara nga vendet e treta, miratuar nga eurodeputetët dhe ndërmjetësuesit e Këshillit, më 3 tetor këtë vit. Marrëveshja u votua me 554 vota, 48 kundër dhe 80 të përmbajtur. Rregullat e reja do të hyjnë në fuqi pasi Këshilli zyrtarisht t'i miratojë ato dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare të BE.

Eurodeputetët Livija Jorka (EPP) dhe Fabio Masimo Kastaldo (EFDD) u zgjodhën nënkryetarë të PE që vinë në vend të z-njës Gal-Pelç dhe M. Lambsdorf. Livija Jorka u zgjodh për nënkryetare me 290 vota, kurse

Fabio Masimo Kastaldo me 325 vota.

Në Rezolutën, e miratuar nga një shumicë e madhe kërkohet nga Komisioni "të iniciojë dialog me Qeverinë e Maltës për funksionimin e sundimit të ligjit në Maltë". Eurodeputetët gjithashtu duan të njoftojnë programet e vendit për shitjen e shtetësisë së Maltës dhe BE-së për qytetarët që nuk janë nga BE. Ata bëjnë thirrje për hetim të pavarur ndërkombëtar, me përfshirjen e plotë të Europolit në vrasjen e gazetares Dafne Karuana Galicija.

Eurodeputetët nuk pranuan zgjatjen e mandatit të kandidatit belg Karel Pinksten në Gjykatën Evropiane të Revizorëve (GJER) dhe miratoi gjashtë kandidatë të tjerë me votim të fshehtë.

Rezultatet e orientuara nga bashkëpunimi dhe besimi i ndërsjellë midis shteteve anëtare janë vendimtare për suksesin e BE, theksoi presidenti i Sllovakisë Andrej Kiska në seancën plenare të Parlamentit Evropian. Ai hodhi poshtë idenë se ekzistojnë "mangësi thelbësore" në arkitekturën e BE-së që do të çojnë në një ardhme të zymtë dhe theksoi se BE duhet të përqendrohet në "zgjidhjen e problemeve së bashku, duke ndihmuar njëri-tjetrin dhe duke mësuar nga njëri-tjetri".

Parlamenti Evropian ka ngritur shqetësime rreth ndarjes së pushtetit, pavarësisë së gjyqësorit dhe të drejtave themelore në Poloni. eurodeputetët besojnë se situata në Poloni paraqet "rrezik të qartë të shkeljeve serioze" të vlerave evropiane, duke përfshirë sundimin e ligjit të garantuar nga Marrëveshjen për BE. Rezoluta e miratuar u bën thirrje autoriteteve polake të mbështesin vlerat e përbashkëta evropiane të nga nenin 2 nga Marrëveshja për Bashkimin Evropian dhe Kushtetutën e Polonisë.

NË FOKUS TË PARLAMENTIT EVROPIAN

Sesioni plenar 29-30 nëntor 2017

Ndërmjetësuesit nga Parlamenti Evropian dhe nga Këshilli arritën marrëveshje për rregullat e para të BE-së për përdorimin civil të fluturakeve pa pilot. Sipas marrëveshjes joformale gjatë projektimit dhe prodhimit e fluturakeve pa pilot do të duhet të respektohen kërkesat themelore të BE-së për mbrojtjen, siguri dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Shtetet anëtare të BE do të jenë në gjendje të urdhërojnë operatorët të regjistronë fluturaket pa pilot që mund të shkaktojnë dëme të konsiderueshme për njerëzit. Fluturaket pa pilot do të duhet të shënohen individualisht për identifikimin e tyre më të lehtë. Qëllimi i këtyre masave që të sigurohet nivel i unifikuar i sigurisë në BE.

Eurodeputetët në seancë plenare miratuan rregulla më të qarta për rendin në të cilin kreditorët e bankave me probleme do të kenë detyrim t'i mbulojnë humbjet. Plani është në të drejtën evropiane të përfshihet standardi ndërkombëtar për "kapacitetin e përgjithshëm për absorbim të humbjeve" të bankave që luajnë rol të rëndësishëm në mbështetjen e sistemit bankar. Rregullat kërkojnë që bankat të ndajnë mjete të mjaftueshme për të absorbuar humbjet dhe për të rikapitalizuar, me ndikim minimal ndaj tatimpaguesve.

Parlamenti Evropian e miratoi marrëveshjen të arritur nga Këshilli në muajin e kaluar dhe që për herë të parë do të sigurojë Fondin e BE-së për Stabilitet dhe Paqe për të financuar forcat ushtarake në vendet partnere në zbatimin e aktiviteteve të tyre të zhvillimore. Mbështetja për ushtrinë deri më tani ishte përjashtuar, edhe pse në disa raste është i vetmi trup për kthimin e sigurisë dhe shërbimet themelore. eurodeputetët ranë dakord të ndajë 100 milion euro për të mbështetur detyrat civile të ushtrisë në vendet e treta dhe për të forcuar Fondin Evropian të Stabilitetit dhe Paqes.

eurodeputetët në rezolutën e miratuar theksuan se Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare do të duhet të shtojnë përpjekjet për të përmbushur plotësisht angazhimet e Strategjisë Evropiane për personat me aftësi të veçanta 2010-2020. Rezoluta vlerëson aktivitetet e strategjisë dhe thekson aktivitetet kyçe në 8 fusha prioritare: qasja, pjesëmarrja, barazia, punësimi, arsimiti dhe

trajnimi, mbrojtja sociale, shëndetësia dhe veprimi i jashtëm. Personat me aftësi të veçanta kanë të drejtën e trajtimit të barabartë, të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të jenë anëtarë të barabartë të shoqërisë, por megjithatë numër i madh i programeve dhe ligjeve, ata ende nuk gëzojnë plotësisht të drejtat.

Eurodeputetët u bënë thirrje shteteve anëtare të BE-së që të zbatojnë legjislacionin në lidhje me të drejtat e qasjes të personave me aftësi të veçanta (duke përfshirë direktivën mbi shërbimet mediatike audiovizive, direktivën për ueb qasjen dhe legjislacionin e transportit). Parlamenti Evropian shpreson që Akti Evropian për Qasje të Personave me Aftësi Veçanta të miratohet shpejt dhe i kërkoj Këshillit të Evropës që t'i japë fund bllokimit në diskutimet për direktivën horizontale kundër diskriminimit.

Për buxhetin e ardhshëm 2018, eurodeputetët ofrojnë më shumë mbështetje për të rinjtë e papunë dhe mjete shtesë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, programet e kërkimit dhe Erasmus. Obligimet e parashikuara për vitin 2018 arritën në 160,1 miliard euro dhe pagesat e aprovuara arritën në 144,7 miliardë euro.

Deputetët votuan për të zgjeruar përdorimin e onlajn sistemi të pagesës së TVSH-së për bizneset që do të reduktonte shpenzimet për harmonizim.

<http://www.europarl.europa.eu>



PËRKRAHJE E MEDIEVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR



Liria e medias është një nga kriteret politike për aderim në BE - të detyrueshme për vendet që duan të aderojnë në Bashkimin Evropian.

Në evenimentin "Ditët e mediave të BE dhe Ballkani Perëndimor" të mbajtur më 9-10 nëntor në Tiranë, Shqipëri, Komisioni Evropian njoftoi se do të investonte në iniciativa të reja për të mbështetur gazetarinë e pavarur, mediet e qëndrueshme dhe për të rritur bashkëpunimin rajonal midis mediave. Në konferencë, Komisioni paraqiti propozime gjithëpërfshirëse për të forcuar pavarësinë e medias në rajon. Fondet e reja të BE do të ofrojnë trajnime për gazetarët profesionistë të rinj dhe nivel të mesëm në të tërë rajonin. Programi i ri i ndihmës teknike për radiodifuzerëve publike do të mbështesë bashkëprodhimin rajonal të gazetarisë hulumtuese, përmbajtjen mediale për të rinjtë dhe digjitalizimin. Aktivitetet e reja me Fondacionin Evropian për demokraci do të jenë në favor të mediave të reja të pavarura dhe iniciativat e vogla.

Komisionari për Politikën për Fqinjësi Evropiane dhe Negociata për Zgjerim Johannes Han, i cili mori pjesë në konferencë, theksoi se "Liria e shprehjes është një vlerë thelbësore e Bashkimit Evropian dhe detyrueshme lidhet me përparimin e mëtejshëm në rrugën drejt BE. Ditët e mediave ballkanike hapin rrugën për një qasje më gjithëpërfshirëse për të mbështetur mediat e pavarura, për të ndihmuar në zgjerimin e shkrimit leximit të medias në rajon, duke ndihmuar digjitalizimin dhe transferimin e njohurive".

Në Programin Rajonal për Trajnim dhe Mbështetje për përmirësimin e kualitetit dhe profesionalizmit të gazetarisë janë paraparë 2 milion euro. Veprimi do të përqendrohet në gazetarët profesionistë të rinj dhe të nivelit të mesëm të trajnuar në gazetari kualitative dhe përmirësimin e botimeve të shkrimeve hulumtuese kualitative. Rrjeti rajonal do të mbështesë zhvillimin dhe shkëmbimin e aftësive kërkimore përmes përfshirjes së gazetarëve, trajnerëve nga BE dhe Ballkani Perëndimor dhe institucioneve akademike. Çmimi i përhershëm i BE për gazetari hulumtuese do të vazhdojë si pjesë e aksionit. Projekti pritet të fillojë në gjysmën e parë të vitit 2018.

Programi i ndihmës teknike për mediat për shërbimet publike në Ballkanin Perëndimor do të ketë një fond prej 1.5 milion euro. Qëllimi i këtij programi është krijimi i standardeve dhe praktikave më të mira në Ballkanin Perëndimor si një kornizë e

përbashkët referimi për mediat e pavarura dhe profesionale. Iniciativa do të gjenerojë singjinez mes 6-të serviset publike për promovimin e këmbimit rajonal për politika dhe praktika. Kjo do të iniciojë fazë të re në procesin e reformës së media, duke përfshirë redaksitë e integruara, udhëzimet editoriale dhe strategjitë afatgjata. Projektet do të fillojnë në fillim të vitit 2018.

Për zbatimin e Skemës për Përkrahje të organizatave të shoqërisë civile dhe Mediave në Ballkanin Perëndimor, janë parashikuar 4 milionë euro. Komisioni, në bashkëpunim të ngushtë me Fondacionin Evropian për Demokraci, do të ofrojë mbështetje që do të orientohet drejt kërkesave të kompanive të reja dhe iniciativave të reja mediatike. Do të mbështetet nga gazetarët, blogerët dhe hulumtuesit në rajon, si dhe mundësinë për të financuar iniciativa të vogla. Edhe këto projekte do të fillojnë në fillim të vitit 2018.

Evenimenti "Ditët e mediave të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor" e vizituan nga më shumë se 250 përfaqësues të mediave dhe organizatave të mediave, si dhe kreatorë të politikës nga BE dhe Ballkani Perëndimor. Në eveniment u diskutua për lirinë e shprehjes, qëndrueshmërinë ekonomike të sektorit të medias dhe rolin e medias në procesin e aderimit.

Dy panele dhe gjashtë punëtori ofruan platformë të gjerë për profesionalizmin e medias për të shkëmbyer pikëpamjet dhe praktikat më të mira. Konferenca kontribuoi të hapet rruga për nismat e reja për promovimin e mediave të pavarura, të qëndrueshme dhe profesionale në rajon.

<http://europa.eu/>

PARIS - QYTETI MË INOVATIV PËR VITIN 2017

Më 7 nëntor, Komisioni Evropian e ndau çmimin për qytet inovativ Evropian (iCapital) në Paris. Çmimi iCapital, i cili arrin në një milion euro, u dha në kuadrin e programit të kërkimit dhe inovacionit të BE "Horizont 2020".


Paris e mori çmimin për strategji inkluzive të saj për inovacione. Talin (Estoni) dhe Tel Aviv (Izrael) u zgjodhën si të ranguar në vend të dytë, dhe iu ndanë nga 100,000 euro. Çmimi me para duhet të përdoret për të rritur dhe zgjeruar më tej përpjekjet inovative të qyteteve.

Paris është kampusi startap më i madh në botë, gjatë dekadës së fundit ka ndërtnuar më shumë se 100.000 metra katror inkubatorë. Qyteti shpenzon 5% të buxhetit të saj në projektet e propozuara nga ana e qytetarëve. Falë kësaj strategjie, qytetarët dhe inovatorët nga sektori privat, jofitimprurëse dhe akademike e kanë bërë Parisin të bëhet FabCity i vërtetë.

Projekti i ri "Reinventing Paris" është shembull i mirë se si qyteti lehtëson inovacionet duke ftuar talente kombëtare dhe ndërkombëtar për të marrë pjesë në rindërtimin e shumë lokaliteteve të rëndësishme. Në projekt, qyteti i ftoi ekipet interdisiplinare të parashtrajnë projekte inovative për zhvillim urban për transformimin e numrit të madh të lokaliteteve nëntokësore në Paris.

Qyteti Talin është shpërblyer për iniciativë të veproje si teren për testimin e teknologjive të fundit të depërtuese. Komuna inkurajoi përdorimin e sistemeve të automjeteve për vozitje të mëvetësishme, robotëve për shpërndarje dhe ndarjen e vozitjeve. Talin, gjithashtu ka implementuar një sistem inovativ të e-qëndrimit që u mundëson qytetarëve dhe bizneseve lokale të bashkëpunojnë ngushtë me kompanitë e huaja.

Qyteti Tel Aviv ka vendosur laborator urbanistik "Smart City" që lidh kompanitë e reja inovative me kompanitë kryesore të teknologjisë për të lehtësuar hulumtimet dhe inovacionin



EUROPEAN CAPITAL OF INNOVATION 2017

e.europa.eu/icapital

#CapitalAwards

European Commission

Finalists:
Aarhus
Berlin
Copenhagen
Helsinki
Nice
Paris
Tallinn
Tampere
Tel Aviv
Toulouse



për të zgjidhur sfidat urbane. Arsimi është ndër prioritetet e Tel Avivit dhe një pjesë e çmimit do t'i kushtohet forcimit të Iniciativës për Arsimim të Zgjuar të zhvilluar nga komuna në bashkëpunim me mësuesit, prindërit, nxënësit dhe gazetarët lokal.

Aplikimi për çmimin qytet Evropian për inovacione filloi në mars 2017 për qytetet me mbi 100,000 banorë nga shtetet anëtare të BE dhe vendet e lidhura me programin Horizont 2020. U paraqitën 32 qytete nga 17 vende. Fituesi dhe të dy finalistët u përzgjedhën në bazë të nismave të reja që filluan më 1 janar 2016. Fituesit u përzgjedhën nga paneli i ekspertëve të pavarur nga universitetet dhe sektori i biznesit nga baza e të dhënave të ekspertëve të Horizont 2020.

Çmimi për herë të parë u dha në 2014 dhe në kuadrin të Horizont 2020, programit më të madh kornizë të kërkimit dhe inovacionit në BE e cila ka buxhet prej 77 miliardë euro për periudhën 2014-2020.

Gara për kryeqendër Evropiane të inovacionit për 2018 duhet të fillojë në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm.

<http://europa.eu/rapid/>

BASHKËPUNIMI MË I FUQISHËM I BE NË SFERËN E MBROJTJES



Më 13 nëntor, më shumë se 20 vende anëtare të BE nënshkruan marrëveshje kryesore për të rritur bashkëpunimin në mbrojtje pas Bregzitet, si dhe më fortë të kundërvihen presionit Rus. Projekti ambicioz nënkupton më shumë alokime për pajisje ushtarake dhe hulumtime, si dhe zvogëlimin e dallimeve në kapacitet e vendeve nënshkruese. Ndër vendet që e nënshkruan marrëveshjen janë Franca, Gjermania, Spanja dhe Italia, ndërsa Britania dhe Danimarka nuk do të marrin pjesë në këtë projekt.

Ministrat e mbrojtjes nga 23 vende në Këshillin e BE dërguan "deklaratë të përbashkët" për programin për bashkëpunim të mbrojtje të strukturës ekzistuese (PESKO). Këshilli duhet të vendosë deri në fund të vitit për të vendosur këtë bashkëpunim, i cili synon të rrisë sigurinë e anëtarëve, si dhe të përmirësojë koordinimin në zhvillimin e pajisjeve të reja ushtarake.

Përpjekje të ngjashme për të thelluar lidhjet ushtarake për dekada kanë qenë problematike, pjesërisht për shkak se Britania ka kundërshtuar fuqishëm atë që mund të rezultojë në formimin e ushtrisë evropiane. Vendimin të cilën Britania e Madhe e solli në vitin 2016 për të braktisur BE-në, si dhe aneksimi i Krimesë në vitin 2014 nga ana e Rusisë, edhe një herë e imponoi nevojën për pozitë më të fortë evropiane në aspektin e sigurisë.

Programi PESKO për të cilën më së shumti angazhohet Gjermania dhe Franca është pjesë e përpjekjeve për të forcuar BE pas referendumit të Bregzitetit, pas çka vijon formimi i Fondit Evropian të Mbrojtjes, i cili do të ketë buxhet vjetor prej 5.5 miliard euro.

Ministrja Spanjolle e Mbrojtjes María Dolores de Kospedal në fillim të nëntorit theksoi se PESKO "në moment është projekti më ambicioz i BE-së".

Marrëveshja që është arritur, parashikon që vendet të japin "mbështetje substanciale" në njerëz, pajisjet, trajnimin dhe infrastrukturë për misionet ushtarake të BE. Nënshkruesit e marrëveshjes

angazhohen për "rritje të rregullt në buxhetet e mbrojtjes", si dhe shpërndarjen e shpenzimeve të mbrojtjes në 20% për pajisjet dhe 2% për hulumtime dhe teknologji.

PESKO mund të çojë në hapjen e spitali ushtarak ose qendër logjistike evropiane, por kryesisht do të fokusohet në projektet për zhvillimin e pajisjeve të reja ushtarake, si tanke ose fluturake pa pilot, me qëllim harmonizimin e sistemeve të armatosura dhe reduktimin e dallimeve në kapacitetet e vendeve të caktuara.

Pjesëmarrja në projektin PESKO është vullnetare dhe vendet mund të bashkohen më vonë nëse ato miratohen nga nënshkruesit e mëparshëm të marrëveshjes. Vendet të cilat nuk janë anëtare të BE-së gjithashtu mund të marrin pjesë në misione të konkrete, edhe pse ato nuk do të kenë rol në vendimmarrje.

Çdo vit, do të kontrollohet nëse nënshkruesit përbushin detyrimet e tyre dhe ata që nuk i përbahen marrëveshjes mund të përjashtohen nga projekti.

Mes Parisit dhe Berlinit, ka pasur dallime të caktuara në lidhje me obligimet e vendeve nënshkruese. Franca angazhohet për pjesëmarrjen e numri të vogël të vendeve që do të përkushtohen në projektet ambicioze, duke përfshirë ndërhyrjet e mundshme ndërkombëtare. Nga ana tjetër, Gjermania ka dashur në projekt të kyçen sa më shumë vende. Duke pasur parasysh se midis 28 shteteve anëtare të BE-së marrëveshja u nënshkrua nga 23 vende, duket se ideja gjermane mbizotëron.

Në kompromis të mundshëm, Britania e Madhe mund të jetë në gjendje të bashkohet, por vetëm në nivel të jashtëzakonshëm, nëse siguron mjete të konsiderueshme dhe ekspertiza.

<https://www.euractiv.com>

SELI TË REJA TË DY AGJENCIVE EVROPIANE

Komisioni Evropian e përshëndeti marrëveshjen e arritur në Këshillin e BE për Çështje të Përgjithshme të arritur më 20 nëntor këtë vit, me të cilën Agjencinë Evropiane të Barnave (AEB) pas Bregzit do të zhvendoset nga Londra në Amsterdam, kurse Agjencia Evropiane e Bankave (AEB) në Paris.

Dy agjencitë Evropiane që zhvendosen nga Londra për shkak të daljes në Britanisë së Madhe nga BE janë kyçe për funksionimin e tregut të vetëm në sektorin për barna dhe atë bankar.

Agjencia Evropiane e Barnave e cila është në Londër që nga viti 1995, punëson rreth 900 njerëz dhe është e angazhuar në testimin dhe kontrollin e barnave për njerëzit dhe kafshët. Kjo agjenci po ndihmon autoritetet kombëtare të miratojnë barna në tregun e vetëm të BE-së që përfshin 28 vende dhe më shumë se 500 milionë njerëz. Agjencia e Barnave e vizitojnë numër i madh delegacionesh dhe ekspertë. Në vitin 2015 ka pasur 36.000 vizitorë, duke përfshirë edhe 4.000 nga vendet të cilat nuk janë anëtare të BE.

Agjencia Evropiane e Barnave e përshëndeti zgjedhjen e Amsterdami për seli të saj. Agjencia paralajmëroi se shumë prej të punësuarve do të duhej lëshohen nga puna nëse zgjidhej qytet më pak tërheqës.

Në intervistë për EURACTIV.com në korrik, ministrja holandez e Shëndetësisë Edit Shipers shpjegoi pse Amsterdami do të ishte ideale për AEB.

" Amsterdami është vend shumë i bukur për të jetuar. Ekonomia është në rritje, ne kemi fuqi punëtore me arsim të lartë dhe aeroporti Schiphol ka numrin më të madh të fluturimeve direkte që lidhin atë me aeroportet e tjera të BE. Kjo, sipas mendimit tim, është shumë e rëndësishme sepse Agjencia e Barnave të BE-së nuk është vetëm një agjenci "e zakonshme", është agjenci që shumë pacientë varen nga e gjithë Evropa ",

theksoi ministri Shipers.

Agjencia Holandeze e Barnave do t'i ndihmojë AEB të bëhet më efikase në selinë e re.

Gjithsej 19 qytete ishin në selinë e EMA-s, e cila do të jetë vend nikoqir dhe do sjellë jo vetëm 900 punonjës, por edhe zyra të shumta të kompanive farmaceutike ndërkombëtare.

Kur bëhet fjalë për Agjencinë Bankare Evropiane (ABE) fitues është Parisi. Nga ana tjetër, Frankfurti selia e Bankës Qendrore Evropiane dhe qytet që dëshiron të bëhet qendra financiare e BE pas Bregzit, në rrethin e dytë të votimit pësoi "humbje". Për seli të Agjencisë Evropiane Bankare u zgjodh Parisi.

Komisioni Evropian do të përgatisë propozime për ndryshimin e rregulloreve për themelimin e dy agjencive. Propozimet do të kufizohen rreptësisht në çështjen e zhvendosjes. Komisioni dhe Këshilli ranë dakord t'i japin përparësi këtyre propozimeve ligjore, në mënyrë që të sigurojnë që agjencitë të mbeten funksionale gjatë këtij procesi. Komisioni me vëmendje do të vëzhgojë nga afër procesin e zhvendosjes dhe do të ndihmojë agjencitë në kuadër të kompetencave të tij, në çështjet që lidhen me buxhetin e BE-së, rregullat e furnizimeve publike dhe çështje kadrovike.

Vendimi për të lëvizur AEB dhe ABE ishte tek qeveritë e 27 vendeve anëtare dhe nuk është pjesë e negociatave për Bregzit.

<http://europa.eu/>



EUROPEAN MEDICINES AGENCY

PËRDORIMI I GLIFOSAT I VAZHDUAR EDHE PËR PESË VITE



Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian kanë miratuar përdorimin e herbicidit të glifosatit në bujqësi për edhe pesë vite. Për propozimin votoi edhe Gjermani e cila paraprakisht ishte e përmbajtur edhe pse ministrja e Mjedisit Jetësor e Gjermanisë nuk ishte e konsultuar.

Ekologët paralajmërojnë se përdorimi i glifosatit se e rrezikon shëndetin e mjedisit jetësor.

Për vazhdimin e lejes për shfrytëzim të glifosatit më 27 nëntor këtë vit votuan 18 vende, kundër ishin 9 vende: Belgjika, Greqia, Franca, Kroacia, Italia, Qipro, Luksemburgu, Malta dhe Austria, ndërsa vetëm Portugalia abstenoj.

Zëri i Gjermanisë për propozimin siguroi shumicën e kualifikuar të nevojshme për votimin e vendimit, pra 65% të popullsisë së BE. Komisionit Evropian me atë morri dritë jeshile për të vazhdimin zyrtar të lejes për të përdorur glifosat, që kompania multinacionale Monsanto e shet nën emrin Raundap (Roundup).

Katër vende, duke përfshirë edhe Gjermaninë ishin të përmbajtura në votimin paraprak. Megjithatë, duket se ndërrimi i pozicionit të Berlinit nuk është rënë dakord në qeverinë gjermane.

Ministrja Gjermane e Mjedisit Jetësor, Barbara Hendriks e Social Demokratëve (SPD), deklaroi se i ka sugjeruar ministrit të Bujqësisë Kristijan Shmit, i cili vjen nga Partia Demokristiane (CDU) se ajo ende nuk pajtohet me zgjatjen e lejes.

Vendimi i Gjermanisë për të mbështetur propozimin, sipas eurodeputetit nga të

gjelbërit Sven Gigold, paraqet "një shuplakë ndaj mjedisit jetësor dhe konsumatorëve".

Ministri i Shëndetësisë i Luksemburgut Karol Disburg gjithashtu e kritikoi vendimin e vendeve të BE, duke thënë se lufta për të hedhur në mënyrë graduale të glifosatit nga përdorimi duhet të vazhdojë.

Në tetor të këtij viti, Parlamenti Evropian miratoi rezolutë me të cilën kërkohet heqja graduale e përdorimit të glifosatit gjatë pesë viteve të ardhshme.

Eurodeputetja Xhuli Girling i grupit të konservatorëve dhe reformatorëve evropianë theksoi se ishte e kënaqur me përdorimin e herbicideve. Ky është triumf i mendimi të arsyeshëm për shkak të fushatës së pamëshirshme të disa grupeve të gjelbra të vendosura për të injoruar provat shkencore dhe për të kujdesur për publikun në mënyrë të panevojshme", tha Girling.

Organizatrat joqeveritare dhe ekologjike njëzëri e dënuan vendimin e BE.

<http://www.euronews.com/>



KUVENDIN I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

BE QENDRA E KUVENDIT

Adresa: 11 Tetori nr. 10, Shkup, 1000

Telefon: +389 2 3 11 22 33 lokal 414 dhe 289

Faks: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

Zyra për përkrahje të Këshillit kombëtar për

www.sobranie.mk

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në periudhën janar 2011-qershor 2012 ishte zbatuar IPA Projekti për "Ndihmë teknike për Parlamentin", qëllimi i përgjithshëm i të cilës ishte përforcimi i kapacitetit institucional të Kuvendit dhe me atë përmirësim të transparencës dhe përgjegjësisë të saj para qytetarëve.

Në korniza të IPA projektit, ishte siguruar ndihmë financiare dhe profesionale për vendosje të BE qendre në Kuvend.

Qëllimi i formimit të UE qendrës është deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe Shërbimit të Kuvendit t'u sigurohet qasje më e mirë në informata të lidhura me BE çështjet.

